



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VI

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Integrime Evropiane

Mbledhja nr. 7

Prishtinë, më 13.11.2017 në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala S-1

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR INTEGRIME EVROPIANE

Në mbledhje morën pjesë: Blerta Deliu- Kodra, Armend Zemaj, Glauk Konjufca, Fitore Pacolli, Fatmire Kollçaku, Ilir Deda, Zenun Pajaziti, Adem Hoxha, Ahmet Isufidhe Milaim Zeka.

Mungoi: Fikrim Damka.

Deputetë tjerë të interesuar: Ali Lajçi, Fatmir Xhelili, Donika Kadaj-Bujupi, Nait Hasani dhe Haxhi Shala.

Mysafirë: Shpejtim Bulliqi, Zejnullah Gruda, Hamdi Basholli, Florim Isufi dhe Skënder Gashi.

Stafi mbështetës i komisionit: Adelina Demolli, Safet Beqiri dhe Florent Mehmeti.

Mbledhjen e kryesoi kryetarja e komisionit, znj. Blerta Deliu- Kodra.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Raportim i z. Shpejtim Bulliqi, kryesues i Komisionit Shtetëror për Shënjimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit Shtetëror;**
- 3. Të ndryshme.**

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

- 1. Miratimi i rendit të ditës**

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Raportim i z. Shpejtim Bulliqi, kryesues i Komisionit Shtetëror për Shënjimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit Shtetëror

Kryetarja: falënderoi Komisionin Shtetëror për Shënjimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit Shtetëror, kryesuesin e saj, z. Shpejtim Bulliqi, për përgjigjen në ftesën e komisionit parlamentar, si dhe sqaroi se ky raportim po bëhet në vazhden e përmbushjes së një nga kriteret për liberalizimin e vizave për Kosovën. Ndërsa, është e ditur se ratifikimi i marrëveshjes së demarkacionit me Malin e Zi është kushti për liberalizimin e vizave, i vendosur nga Bashkimi Evropian, kurse sot në këtë takim është ftuar ky komision shtetëror, lidhur me ecurinë e punës së tij dhe të gjeturat në këtë proces, si dhe njoftimi lidhur me një vizitë që keni pasur kohëve të fundit në Slloveni dhe Kroaci.

Shpejtim Bulliqi: si kryesues i Komisionit Shtetëror për Shënjimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit Shtetëror, ka paraqitur të gjitha të dhënat që posedon dhe ecurinë e deritanishme lidhur me marrëveshjen për shënimin e vijës kufitare të Kosovës me Malin e Zi. Mirëpo, në cilësinë e kryesuesit, tregoi se ky komisioni është ende duke punuar për finalizimin e raportit lidhur me këtë çështje, dhe do të pritët që brenda një periudhe të caktuar kohore, ky raport të prezantohet së pari në Qeverinë e Kosovës dhe më pas, përmes saj edhe në Kuvend.

Duke treguar në mënyrë kronologjike zhvillimin e punës së këtij komisioni, ai tha se puna e tij është bazuar në dy lloje të fakteve: 1. Faktet që kanë të bëjnë me analizat e materialeve të përdorura në institucionet e ndryshme; 2. Grumbullimi i të gjitha fakteve dhe të gjeturave.

Sa i përket vlerësimit të punës së ish-Komisionit Shtetëror, sipas tij, pala e Kosovës, qysh në takimin e dytë ndërmjet dy vendeve e ka pasur të qartë që territori i Kosovës po humbet dhe ka ofruar një fakt ose dëshmi siç është harta topografike që është 1 me 50 mijë dhe 1 me 100 mijë, e cila e definon qartë kufirin administrativ në mes Kosovës dhe Malit të Zi. Mirëpo, ajo që ka ndodhur në fund dhe që është prodhimi në fund i këtij ish-komisioni, është harta topografike me dimensione 1 me 25 mijë, e po të njëjtit institut të asaj kohe, vetëm që është e vetmja harta topografike që nuk ka pasur vija të kufirit. Pra, sipas tij, është rivizatuar kufiri dhe këtë e bazon në bazë të procesverbaleve të mbledhjeve të ish-komisionit, pra një vijë kufitare, e cila është vizatuar nga pala malazeze. Gjithashtu, ka potencuar se puna e tyre është duke u realizuar nën presionin e deputetëve dhe mediave, ndërsa nga disa institucione shtetërore, madje nuk kanë gjetur bashkëpunim të duhur për këtë çështje.

Sipas tij, ish-komisioni nuk ka bërë punën e tij, në mënyrë transparente dhe ka tejkaluar kompetencat e veta, për faktin se ka mungesë të një marrëveshjeje ndërkombëtare dhe ka qenë i themeluar vetëm me një detyrë, demarkimin e atij kufiri, shënjimin dhe mirëmbajtjen, por në asnjë formë dhënien e një vije të re kufitare në praktikë, gjë që për fat të keq rezultati final na ka rezultuar vija e re kufitare mes Kosovës dhe Malit të Zi.

Gjithashtu, ky komision, tani nuk guxon të ngutet në dëm të raportit, sepse çështja është serioze dhe nuk është larg përgatitjes dhe finalizimit të tij, pasi që së shpejti ky raport do të prezantohet me të gjitha faktet e mbledhura.

Kryetarja: tha se për punën e këtij komisioni nuk janë të interesuar vetëm anëtarët e Komisionit për Integrime Evropiane, por dhe të gjithë qytetarët e Kosovës, lidhur me çështjen e demarkacionit. Për shkak të numrit të madh të interesuarve, pra jo vetëm të anëtarëve të këtij komisioni parlamentar, ka edhe deputetë tjerë që kanë shfaqur interesim për këtë çështje, prandaj fillimisht do të merren pyetjet dhe pastaj përgjigjet e Komisionit Shtetëror për Shënjimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit Shtetëror. Pastaj, hapi diskutimin.

Milaim Zeka: tha se e kupton presionin që ka kryesuesi i Komisionit Shtetëror, z. Shpejtim Bulliqi dhe anëtarët e tjerë, nga mediat, Qeveria dhe Kuvendi, për shkak të çështjes për liberalizimin e vizave. Ka përmendur Rezolutën e miratuar në Kuvend, më 15 qershor 2015, e cila gjithashtu e mban përgjegjës z. Bulliqi, pasi që ka qenë pjesë e asaj legjislature dhe në Kuvend nuk ka raportuar as ministri i Punëve të Brendshme, Skënder Hyseni dhe ministri i Punëve të Jashtme Hashim Thaçi. Pyeti rreth ekzistimit të një marrëveshjeje, e cila ka qenë në nivel federativ, e përcaktimit të kufijve, kopjet e së cilës ekzistojnë në Shkup, Lubjanë, Zagreb, Beograd, në Mal të Zi dhe në Sarajevë. Pyeti, nëse ata kanë hasur në arkivat federative në kopjet e kësaj marrëveshjeje për përcaktimin e kufijve në mes të republikave dhe krahinave autonome të asaj kohe. Kurse, pyetja e dytë, kishte të bënte me presionin, nëse ata janë në gjendje që të përballojnë gjithë këtë presion, me qëllim që ata të punojnë në mënyrë të pavarur. Në pyetjen e tretë, tha se nëse është humbur territor, a duhet të kyçet prokuroria, nëse është shkelur Kushtetuta, ndërsa nësi deputetë, jemi betuar që Kushtetutën të mos ta shkelim. Pra, të veprohet ashtu siç është rasti i Shqipërisë, sa i përket marrëveshjes me Greqinë.

Zenun Pajaziti: tha se interesimi kaq i madh nuk duhet të merret si presion, por interesim legjitimi i qytetarëve të Kosovës dhe mediave, pasi që të gjithë, në një mënyrë apo në një tjetër, kanë qenë të përfshirë në një kohë të gjatë në këtë proces. Nga ky komision ka pritur më shumë argumente rreth demarkacionit dhe të ndihmohen institucionet e Kosovës për mbylljen e kësaj çështjeje. Sipas tij, qysh atëherë, kryesuesi i këtij Komisioni Shtetëror ka pretenduar të flasë më shumë si ekspert, kurse ka qenë politikan. Kam pritur që të keni më shumë argumente me ekspertët, për të treguar diçka më konkrete se sa që i thatë ato, sot, përveç vizitës që është realizuar në Slloveni dhe Kroaci dhe që është dashur, sipas jush, që ish-komisioni të realizonte një të tillë më herët.

Ai tha se nuk ka asnjë emocion për ish-komisionin dhe as për këtë komision, ku ishte i interesuar që të dalë diçka shpejt dhe të përfundojë ky proces. Argumentet janë politike, siç është Pako Ahtisaarit, e cila ka sjellë pavarësinë e Kosovës. Sipas tij, nuk duhet sjellë hartat që abuzojnë me ato hartat e përdorura këtu, por mendon se është një moment për t'i nxjerrë ato argumente, të cilat e mbyllin këtë histori dhe që ndihmojnë

institucionet e Kosovës për të mbyllur këtë çështjeje, pas një kohe të gjatë. Pra, atë që dëgjuam ne këtu, ishte vetëm për ish-komisionin e kaluar. Mirëpo, kjo nuk duhet të merret si presion ndaj komisionit aktual, dhe nëse ka pasur nevojë, kjo mbledhje është dashur që të kërkohet të shtyhet për një javë, me qëllim që të dilnit sa më të përgatitur përballë komisionit parlamentar.

Fatmire Kollçaku: falënderoi për punën e këtij Komisioni Shtetëror dhe tha se ky komision është i angazhuar nga Qeveria aktuale, ashtu siç ka qenë i angazhuar ish-Komisioni Shtetëror nga Qeveria e kaluar. Po ashtu, tha se u prezantuan shumë shkelje procedurash, të punës së ish-komisionit, ligjeve në fuqi dhe procedurave, sipas së cilës dikush duhet të shkojë në përgjegjësi. Pyeti: pse është anashkaluar institucioni më i lartë në Kosovë, siç është Kuvendi i Kosovës? Ka ekzistuar një bazë juridike e cila nuk është respektuar dhe nuk ka pasur një marrëveshje ndërkombëtare. Ndërsa, sot jemi në një kohë tashmë të përfunduar, *`post mortum`*, sepse kjo marrëveshje nga Mali i Zi është ratifikuar tashmë dhe ndodhemi në situatën, nëse duhet të dërgohet në arbitrazh apo të rinegociohet. Në fillim ka qenë edhe pëlqimi i palës malazeze për t'u ulur dhe biseduar për këtë çështje, por retorika e Malit të Zi ka ndryshuar.

Pyeti: sa kohë i duhet këtij Komisioni Shtetëror, për të dalë me raport të kompletuar dhe të procedohet në Kuvend, që të prezantohet para deputetëve?

Ahmet Isufi: falënderoi Komisionin Shtetëror për punën dhe theksoi se është e kuptueshme që një numër i madh i vendeve që kanë dalë nga luftërat ose konfliktet ndërmjet tyre, kanë pasur probleme të tilla në zgjidhjen e çështjes së kufijve shtetërorë. Ka konsideruar se shpreh pikëpamjet e tij, lidhur me rëndësinë e punës së këtij Komisioni Shtetëror, i cili detyrë parësore ka territorin e Kosovës dhe të vërtetojë vijën territoriale të kufirit me Malin e Zi. Ndërsa, foli për defektet që janë evidentuar në punën e ish-Komisionit Shtetëror, siç është përdorimi i standardeve jo të duhura për matjen e kufirit, sikurse ka ndodhur me vendet tjera apo lënia në dorë për vendosjen e kufirit, shtetit të Malit të Zi. Sa i përket kohës, sa më shpejt që kjo të bëhet, do të jetë më mirë, por kërkoi nga anëtarët e këtij komisioni mos të bien pre e asnjë presioni, para presionit të ndërgjegjes së tyre. Pra, para së gjithash, interesat e popullit të Kosovës dhe shtetit duhet të mbrohen. Kosova ka humbur territor edhe në të kaluarën.

Po ashtu, kërkoi që ata të bazohen në aspektin profesional, sepse nuk ka nevojë që askujt t'i falet tokë dhe është koha e fundit kur njerëzit do të mbrojnë interesat e vendit të tyre.

Ilir Deda: tha se në të kaluarën ka pasur mostransparencë në punën e ish-Komisionit Shtetëror, prandaj sot janë ftuar këtu në raportim, për t'u informuar në çdo fazë të punës së tyre dhe kërkoi që të publikohen procesverbalet e ish-Komisionit Shtetëror të kaluar. Po ashtu, pati vërejtje, pasi që raportimit të tij nuk i ka paraprirë një raport me shkrim dhe këtë prezantim që e bëtë para mediave dhe para anëtarëve të Komisionit për Integritet Evropian, ta dorëzonte me shkrim si dhe të bëhej publik.

Ai, kryesuesit të Komisionit Shtetëror, z. Shpejtim Bulliqi, i parashtrori tri pyetje: 1. A ekzistojnë dokumente të cilat flasin mbi administrimin efektiv të Kosovës për territorin që është deri në Kullë dhe Belluh? 2. A kanë konsultuar vendimin e Gjykatës së Arbitrazhit për Slloveninë dhe Kroacinë, i cili është dhënë në qershor të vitit 2017? Sepse ku nuk ekziston dokumenti kadastral, që të merret ushtrimi i kontrollit efektiv i territorit. Ajo që nuk bën të ndodhë është të dëshmohen vetëm gabimet e Ish-Komisionit Shtetëror dhe mandej, “pataten e nxehtë” t’ia leni në dorë në fund 120 të vendosin, por të këtë reflektim edhe të situatës aktuale që ndodhet Kosova. 3. Kur do të dalë raporti përfundimtar rreth të gjeturave për çështjen e demarkacionit? Ndërsa, nëse zgjatet puna e këtij raporti, të organizohet edhe një takim i përbashkët.

Armend Zemaj: tha se kanë përgjegjësi që të raportojnë edhe për faktin që janë duke u paguar për të bërë këtë punë. U shpreh se nuk ka dëgjuar asgjë të re, sot, nga anëtarët e Komisionit Shtetëror apo është i informuar mirë dhe në të tërësi me këtë proces. Në kuadër të kësaj, kërkoi nga ta, mundësisht të thonë diçka të re nga ajo që tashmë është dëgjuar ndër vite dhe ka qenë pjesë e debateve. Gjithashtu, u shpreh se nuk ka diçka të re që këtyre deputetëve të Kuvendit të Kosovës, t’i bëjë koshientë apo vigjilentë, se do të kenë një rekomandim si të ecet më tutje, përpara. Kurse, sa i përket pretendimit se ka shkelje kushtetuese dhe interpretimit të nenit 40 të Kushtetutës, tha se nuk mund bëhen nga ta interpretime të Kushtetutës. Në bazë të përmendjes së tre fakteve që jeni duke punuar, nuk pati asgjë të re, nga aspekti i ndarjes ndërkombëtare të vijës kufitare as nga aspekti kadastral, kurse ishte kureshtja tek kontrolli efektiv i territorit.

Pyeti komisionin: çka nënkuptojnë me kontroll efektiv dhe cilat janë të gjeturat e reja? Nëse ka diçka të fshehur, ky komision parlamentar mund të mbajë takime edhe me dyer te mbyllura. Duhet të bëhet vetëm punë profesionale dhe faktike, të silltet para Kuvendit, dhe të mos bëhet politikë për qytetarët e Kosovës, sepse pjesa tjetër e ka marrë përgjigjen politike, të pjesës së pozitës dhe opozitës.

Po ashtu, ka shprehur dyshimet e tij për këtë proces, për shkak të mundësive për hedhje të fajit ndaj njëri-tjetrit. Megjithatë, pati tre sugjerime: 1. Nëse keni dilemë rreth mandatit të ish-komisionit shtetëror, të referohet në Gjykatën Kushtetuese, e cila është kompetente për atë punë, pra duhet që të referohet në Gjykatën Kushtetuese për vënien e verdiktit final. 2. Pjesa që ka të bëjë me nënshkrimin e marrëveshjes e cila duhet të faktohet, se a është ashtu siç është nda Jugosllavia me anë të Badinterit apo është vetëm pjesa kadastrale e saj. 3. A janë të gatshëm për t’u përballur me ish-Komisionin Shtetëror lidhur me të gjeturat e reja, të prezantuara?

Mos të bëhet një raport, i cili nuk paraqet asnjë vendimarrje dhe vendos institucionet në situata të palakmueshme.

Fitore Pacolli: ka përgëzuar për punën Komisionin Shtetëror dhe tregoi pse është ftuar në raportim. Demarkacioni, si çështje, nuk është dashur të lidhet me liberalizimin e vizave, sepse demarkacioni ndërlidhet me sovranitetin e vendit, i cili është tentuar të cenohej nga brenda, nga Qeveria e Kosovës dhe jo nga jashtë.

Anëtarët e këtij komisioni duhet të kërkojnë nga partnerët evropianë që demarkacioni të largohet si kusht për liberalizim të vizave dhe i vendosur si kusht i padrejtë për qytetarët e Kosovës, sepse një lëvizje të lirë ua ka mundësuar qytetarëve të Malit të Zi , pa përmendur edhe vendet tjera fqinjë.

Po ashtu, tha se ekzistojnë informata se Qeveria e Kosovës, vetë ka kërkuar të vihet demarkacioni si kusht për liberalizim të vizave, me qëllimin që kjo të përfundojë shpejt dhe si një çështje thjesht teknike, ose për të mbuluar dështimet e Qeverisë për përmbushjen lidhur me kushtin kryesor për luftimin e korrupsionit dhe krimin të organizuar. Ish-komisioni, vendosjen e kufirit në dëm të tokave shqiptare e la në dorë të vendosjes, te pala malazeze. Sipas saj, ishte presioni i qytetarëve përmes petitionit të mbi 200 mijë nënshkrimeve, ekspertëve, profesorëve dhe opozitës në Kuvend, për mos-humbjen e mbi 8 mijë hektarëve tokë. Kërkoi që të mos bëhet presion ndaj këtij Komisioni Shtetëror për dorëzimin e shpejtë të raportit, si dhe kërkoi që në të njëjtën kohë të hiqet demarkacioni, si kusht për liberalizim. Pra, ky demarkacion i paraqet probleme Kosovës, në aspektin ekonomik, burimeve ujore dhe të sigurisë. Mesazhet e ditëve të fundit që u dhanë, kinse Kosovës i kanë mbetur shumë pak kohë për të miratuar demarkacionin, për shkak të zgjedhjeve të ardhshme të Parlamentit Evropian, është një mashtrim, sepse edhe po të ratifikohet marrëveshja nuk garanton liberalizimin e vizave, për shkak të kriterit për luftimin e korrupsionit dhe krimin të organizuar.

Një çështje tjetër është problemi me refugjatë, që ballafaqohet BE-ja dhe shtetet anëtare dhe disa shtetet veç kanë vendosur masa të rrepta të kontrolleve kufitare, si në Gjermani, Danimarkë, Norvegji, Francë dhe Austri. Në këtë aspekt, Kosova ende vazhdon të ketë shkallë të lartë të migrimit, sipas raportit “Profili i migrimit 2016” i MPB-së, ku vetëm në 2016 kanë migruar 122.657 persona. Kosovarëve, gjithashtu janë duke iu refuzuar me të madhe vizat nga disa shtete, siç është Gjermania, prandaj BE nuk duket e gatshme për një liberalizim të vizave, dhe për qytetarët e Kosovës nuk do të ketë liberalizim as në vitin 2018.

Fatmir Xhelili: tha se i vjen keq që ndoshta kanë ardhur të papërgatitur dhe jeni në fazën fillestare. Ai theksoi se ka pritur prej këtij komisioni dhe prej agresiviteteve që atëherë i kanë prezantuar si argumente për të faktuar punën jo të mirë të ish-komisionit. Ndërsa, sot komisioni nuk është përcaktuar për të folur me fakte konkrete, të cilat determinojnë sipërfaqen e Kosovës dhe vijën kufitare me Malin e Zi. Pra, ka shprehur zhgënjimin e tij lidhur me punën e këtij komisioni, si të papërgatitur dhe prezantimi që ka dëgjuar nuk është bindës se Republika e Kosovës është duke humbur territor. Ai kërkoi të dijë se kur mund të jetë raporti i tij i gatshëm, sepse ka zgjatur shumë, sipërfaqen e Kosovës, metodologjinë e punës së këtij Komisioni Shtetëror, etj. Në fjalimin e tij, ka përmendur disa të dhëna dhe procesin nëpër të cilin ka kaluar Kosova deri në shpalljen e pavarësisë së saj.

Ali Lajçi: kërkoi që Komisioni Shtetëror për Demarkacionin me Malin e Zi, të vazhdojë punën, pa presione dhe se të gjithë duhet të lënë anash “pallavrat”, sepse dihet që është prekur territori i Kosovës. Për këtë çështje, të gjithë keni bërë komente

nga pak dhe është punë e këtij komisioni të gjejë defektet, nëse është deformuar edhe kadastra. Sipas tij, një komision që është marrë me hapësirën territoriale të Republikës së Kosovës, ka gjetur se mungojnë 2 mijë hektarë në Debëllde. Prandaj, konsideron se Kosova ka humbur territor edhe me Malin e Zi dhe është deformuar kadastra në këtë pjesë.

Kryetarja: ndërhyri, duke tërhequr vërejtjen deputetit Lajçi, rreth përdorimit të gjuhës ndaj deputetëve tjerë. Ka shtuar se lidhur me përmendjen e kriterit kadastral, i cili gjithashtu vlen si kriter, i cili përmendet në vendimin e Gjykatës së Arbitrazhit në mes të Sllovenisë dhe Kroacisë, se kriteri kadastral vlen kryesisht për kufirin ndërmjet këtyre dy shteteve.

Shpejtim Bulliqi: gjatë përgjigjeve, tha se ky komision ka pasur për detyrë edhe gjetjen e fakteve të reja me analiza efektive ose kontroll efektiv. Për një muaj e gjysmë ka bërë edhe punë në terren për hulumtimin e materialeve brenda dhe jashtë vendit. Gjithashtu, ka shprehur brengosjen e tij për këtë proces, mirëpo tha se janë duke punuar në mënyrë efikase, në mënyrë që të dalim me rezultate finale. Në përgjigje të pyetjes rreth vendimit për Slloveninë dhe Kroacinë, ata gjatë vizitës në takimet që kanë mbajtur atje, prezantojnë dëshmi të kadastrës të një kafeje, të cilën e ndan përgjysmë kufiri, përderisa pyet se ku është kufiri kadastral aty, sepse duhej të përfshihet në njërën anë ose në anën tjetër. Ka dallime në mes të kufirit kadastral dhe kufirit administrativ. Serbia dhe Mali i Zi, në të kaluarën, këtë kufi e kanë shndërruar nga kufi kadastral në kufi administrativ.

Sipas tij, komisioni është shumë i interesuar të dalë sa më shpejt që është e mundur, me raport. Pra, do të jetë jo vitin e ardhshëm, jo pas tre muajve, por do të jetë këtë vit dhe do të bëhet shumë shpejt. Procesi ndodhet në fazën e rrumbullakimit të fakteve që ekzistojnë dhe materiali është duke u vendosur në letër dhe së shpejti do të kryhet procesi. Puna e komisionit është punë tipike profesionale, e pandikuar dhe e paanshme ndaj askujt. Gjithashtu, tha se në kemi ardhur këtu, në cilësinë e njerëzve që e kuptojnë pak a shumë këtë problematikë, pa ngjyrimet politike, edhe pse vetë deklaroi se dihet se ka qenë dhe mbetet pjesë e LDK-së. Po ashtu, u shpreh se puna e tyre ka qenë e pavarur dhe pa ndonjë interes nga shteti, nëse del mirë apo jo, ata nuk do të japin llogari për punën e tyre, por japin përgjegjësi për faktet e tyre, të cilat i ofrojnë. Ndërsa, për punën e ish-komisionit e ka cilësuar si joprofesionale dhe jotransparente.

Gjatë prezantimit të tij, gjithashtu ka përdorur disa harta dhe dokumente.

Florim Isufi: rreth përgjigjeve të pyetjeve të deputetëve, lidhur me faktet e gjetura deri më tani nga ky komision për rishikim të kufirit, tha se duhet pasur kujdes se në cilat dokumentacione bazohet për kufirin me Malin e Zi, sipas të cilit, vija kufitare me ish-Jugosllavinë ka lindur pas vitit 1946. Gjithashtu, ka folur për vizitat e komisionit nëpër arkiva të shteteve të ish-Jugosllavisë, prej të cilave kanë siguruar disa dokumente, ndërsa për sigurimin e dokumenteve tjera kanë hasur në vështirësi, pasi nuk po u lëshohen nga arkivat e ish-Jugosllavisë. Ai ka pohuar se kanë siguruar

dokument ku tregohet shtrembërimi i kufirit mes Kosovës dhe Malit të Zi. Sipas tij, ekziston dhe ka persona që e kanë pa atë dokumentacion dhe ka shtuar se po provojnë ta marrin edhe atë dokument, i cili ndodhet në fondin arkivor të arkivit jugosllav. Janë shqyrtuar dhe vendimet e arbitrazhit për Slloveni dhe Kroaci dhe kanë diskutuar për punën e kadastrit. Në rastin e tyre ka pasur dy hipje kadastrale dhe është dashur të vendoset se ajo pjesë cilit territor i takon. Gjatë vizitës janë takuar me përfaqësues të Arkivit Shtetëror të Kroacisë, Institutit Kombëtar Hartografik të Kroacisë, Arkivit Shtetëror të Sllovenisë, institucionit gjeodezik slloven, Ministria e Mbrojtjes së Kroacisë dhe dy ose tre institucione tjera me interes, për të mbledhur fakte. Sipas tij, gjatë takimeve iu është thënë se pjesa e kontestuar e territorit ndërmjet Kroacisë dhe Sllovenisë, 90% e saj i ka takuar Kroacisë, ndërsa 10% Sllovenisë.

Gjithashtu, ka prezantuar dy harta të zonave kadastrale të Kosovës dhe të Malit të Zi, të cilat dëshmojnë se ka mbi hipje deri në 6 mijë e 5 qind hektarë të zonave kadastrale dhe të dy hartat janë zyrtare, njëra e vitit 1988, tjetra e vitit 1991 dhe me një shkallë të vogël me 550 mijë e Malit të Zi, e cila për gjeografët është e identifikueshme. Dhe një hartë e Kosovës me 1 mijë e 400 mijë, e cila është punuar nga ish-Drejtorja për Gjeodezi e Krahinës Socialiste Autonome e Kosovës, në vitin 1974. Kurse, këto dy harta, nëse bashkohen, ato kanë mbi hipje deri në 6 mijë hektarë.

Donika Kadaj- Bujupi: tha se sipas tyre, puna që do të bëhet është të analizojë punën e ish-Komisionit Shtetëror, së bashku me të gjeturat dhe rekomandimet. Ndërsa pyeti për mandatin e Komisionit Shtetëror aktual, se a duhet mandat shtesë lidhur me shqyrtimin e mëtutjeshëm.

Zejnullah Gruda: tha se nga gjetjet e tij, ai ka vërtetuar se Kosova me Malin e Zi nuk ka marrëveshje për demarkacion, por ka marrëveshje për kufi, e cila është nënshkruar më 26.2.2015, e nënshkruar nga Hashim Thaçi, zëvendëskryeministër i parë dhe ministër i Punëve të Jashtme dhe Skënder Hyseni, ministër i Punëve të Brendshme. Neni 4 i kësaj marrëveshjeje, thotë se kufiri shtetëror ndërmjet palëve do të shënohet me shenja kufitare, sipas paragrafi të parë. Kurse, paragrafi i dytë, thotë se kufiri shtetëror ndërmjet palëve do të shënohet në periudhën prej dy viteve, nga hyrja në fuqi e kësaj marrëveshjeje. Pra, do të thotë, për demarkacionin, ne ende nuk i kemi kushtet formale për të biseduar, është bërë “Marrëveshje për kufi”. Ndërsa, ish-Komisioni Shtetëror ka bërë një punë e cila është delimitacioni, kufijtë administrativë ose kufijtë avnojan, janë kufijtë që i ka përcaktuar Komisioni i Gjillasit, më 1945, në të cilin kanë marrë pjesë krejt udhëheqësit më të lartë të shtetit. Ndërsa, Komisioni i Badinterit, këta kufij të Gjillasit i ka shndërruar në kufij administrativë. Dy komisionet, i Kosovës dhe Malit të Zi, kanë pasur dallim dhe mandat të ndryshëm ndërmjet tyre. Ndërsa, kriteri kadastral nuk është kriter në të drejtën ndërkombëtare, si një kriter, duke përmendur rastin e kufirit ndërmjet Serbisë dhe Kroacisë. Kadastra është për përcaktimin e pronarëve dhe jo përcaktues për kufirin ndërmjet shteteve.

Hamit Basholli: ka shpjeguar çështjen e kadastrit, në përgjithësi, do të thotë atë në ish-Jugosllavi, në fillim vetëm për nevoja tatimore, duke u nisur që nga koha e

Perandorisë Osmane, pastaj tek ajo Austro-Hungareze, të cilat kanë ndryshuar, ashtu siç janë bërë matjet. Gjatë prezantimit të tij ka treguar se komunat mund të posedojnë territor, i cili nuk është i regjistruar me numër në kadastrë, mirëpo është si pronë komunale. Pra, ka prona që ekzistojnë nga drejtoria e pyjeve, por që nuk janë të regjistruara dhe nuk kanë certifikatë kadastrale. Në vitin 1984, është bërë një fluturim për shënjimin e kadastrit në Kosovë dhe në pjesë tjera të ish-Jugosllavisë. Mandej, urdhri për revidimin e kadastrit në ish-Jugosllavi, në vitin 1948, ka kërkuar që të gjithë ata që administrojnë me prona, të bëjnë matjet e tyre.

Në përgjigje të pyetjeve të deputetëve, tha se vetë kadastri nuk i ka të gjitha pronat e veta të regjistruara, pra nuk ka prona pa pronar, sepse pronar është shteti, mirëpo shteti nuk i regjistron pronat vetë në kadastrë, për të marrë certifikatë për ato prona. Pra, ekzistojnë prona shtetërore që nuk janë të regjistruara në kadastrë, si parcela.

Skënder Gashi: ka folur për kontrollin efektiv të territorit, i cili është ushtruar nga policia kufitare dhe Dogana e Kosovës, mirëmbajtjen e rrugëve dhe shenjave të trafikut. Ai ka prezantuar një dokument të stacionit të policisë së Kosovës në Kullë, gjegjësisht të lëshuar nga komandanti i policisë, ku më 12.1.2009, urdhëron kompaninë e mirëmbajtjes së rrugëve gjatë dimrit, që të tërhiqet rreth 5 ose 6 km më në jug, që tash është vendi ku është vendosur policia kufitare dhe Dogana e Kosovës, në vendin e quajtur “*Salina voda*”. Ky dokument është bazuar në një bisedë telefonike që është zhvilluar me policinë kufitare të Malit të Zi. Në bazë të kësaj, ai tha se stacioni policor kufitar ka ekzistuar në vendin e quajtur Kullë dhe ka operuar policia e Kosovës, deri në këtë kohë, ku është marrë vendimi për t’u tërhequr.

Gjithashtu, janë mirëmbajtur atorrugë nga ana e Kosovës, që do të thotë se është kontrolluar efektivisht kjo pjesë e territorit, i cili është zhvendosur pas vitit 2009 e këndej.

Glauk Konjufca: tha se vendimi i Qeverisë së Kosovës, për ta ndërruar përbërjen e këtij Komisioni Shtetëror, ka qenë i qëlluar dhe i mirëseardhur. Vendosja e njerëzve në krye të këtij Komisioni Shtetëror, njerëz që kanë argumentuar më së miri, kanë problemet dhe defektet, ndërsa sa i përket fakteve të ofruara, mendoj se janë fakte të qëlluara dhe të qëndrueshme, duke filluar nga aspekti i së drejtës ndërkombëtare, ashtu siç u shpjegua nga prof. Zejnullah Gruda, askund shtetet nuk janë mbledhje e komunave dhe nuk caktohen kufijtë askund ashtu. Çështja tjetër është aspekti kadastral, sepse as Kosova dhe as Mali i Zi nuk ka mbulim kadastral, ndërsa argumenti i kontrollit efektiv është gjithashtu një argument shumë i qëndrueshëm, por që ky ushtrim i kontrollit efektiv ka munguar pas vitit 2009, e cila duhet të adresohet në aspektin politik. Vendimi i komandantit të policisë kufitare për t’u tërhequr nuk mund të cilësohet si vendim krye në veti, prandaj duhet adresim politik i përgjegjësive në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Ne duhet të shkojmë deri te përgjegjësia, të shikohet se a ka pasur vendim politik për zmbropsje të kontrollit të kufirit prej 5.6 km, më në jug se që ka qenë kontrolli i kufirit.

Sipas së drejtës ndërkombëtare, kufijtë e saktë dhe objektivë ngadhënjëjnë mbi kontrollin efektiv të territorit, sepse kemi raste të ndryshme nëpër botë, siç është rasti i

Krimesë, e cila kontrollohet nga Rusia, mirëpo e drejta ndërkombëtare nuk e njeh, për shkak se është e padrejtë dhe e paligjshme. Gjithashtu, vlen edhe për Malin e Zi, që fut në territorin e Kosovës dhe duhet të tërhiqet dhe të argumentohet nga ky Komisioni Shtetëror, me argumente, siç është sipas së drejtës ndërkombëtare dhe kufijtë të vendosen me delimitim, qysh ka ndodhur prej mbas Luftës së Dytë Botërore, pastaj Badinteri është një konfirmim i dytë dhe shpallja e pavarësisë është një konfirmim i tretë.

Shpejtim Bulliqi: sipas tij, ish-komisioni ka tejkaluar kompetencat e veta, për faktin se ka mungesë të një marrëveshjeje ndërkombëtare dhe ka qenë i themeluar vetëm me një detyrë, demarkimin e atij kufiri, shënjimin dhe mirëmbajtjen, por në asnjë formë dhënien e një vije të re kufitare në praktikë, gjë që për fat të keq rezultati final ka rezultuar vija e re kufitare mes Kosovës dhe Malit të Zi. Puna e këtij Komisioni Shtetëror është mirëmbajtja dhe kontrolli i kufirit të Kosovës dhe jo vetëm me Malin e Zi. Gjatë përgjigjeve të pyetjeve, ka prezantuar disa dokumente, siç tha, është vula në dokumentet e udhëtimit të qytetarëve, e lëshuar nga institucionet e Kosovës në kufi, më 12 maj 2015, pastaj më 1 nëntor 2017, ku shkruan pika kufitare Kullë, e të tjera. Ndërsa, sot pika kufitare e Kosovës është shqip, thuhet vendi i quajtur “*Uji i Sali Agës*”.

Pas një diskutimi të gjatë, në fund premtoi se të gjitha faktet do t’i vendosin në një raport përfundimtar dhe do ta bëjnë publike në Qeveri, dhe Kuvendi, në fund, do ta marrë vendimin politik.

Mbledhja përfundoi në orën 13:30.

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e komisionit.

Kryetare e komisionit,

Znj. Blerta Deliu-Kodra